

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sikagard®-907 W

### MBROJTËS PËR SIPËRFAQET POROZE DHE STABILIZUES I RËRËS TEK FUGAT

#### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikagard®-907 W është izolues rrëshire me bazë uji dhe 1 përbërës me rezistencë ndaj rrezatimit UV. Sikagard®-907 W ka veprim të dyfishtë: mbron sipërfaqet poroze nga uji dhe njollat e vajit dhe stabilizon rërën brenda fugave.

#### PËRDORIMET

Sikagard®-907 W është krijuar për të mbrojtur në mënyrë efektive dyshemetë me blloqe shtrimi dhe nënshtresat poroze nga uji, vaji dhe materiale të tjera dëmtuese.

Gjithashtu, për shkak të vetive unike lidhëse të tij, kur aplikohet në fuga të mbushura me rërë, Sikagard®-907 W depërton në rërën e fugave duke i stabilizuar dhe izoluar ato.

Mund të përdoret në zonat e mëposhtme:

- Zona këmbësorësh dhe trotuare
- Tarraca
- Në vende parkimi automjeteve dhe rampa
- Korridorët dhe rrugët udhëzuese të automjeteve
- Dyshemetë e shtruara me pllaka në pika furnizimi me karburant (në varësi të kufizimeve lokale)
- Qendra tregtare, etj

Sikagard®-907 W mund të aplikohet mbi nënshtresat poroze të mëposhtme:

- Blloqe shtrimi
- Kalldrëme natyrale poroze ose të riformuara
- Dysheme betoni
- Sipërfaqe betoni me agregate të ekspozuara

#### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- 1 përbërës, nuk nevojitet hollim ose tretje
- Miqësor ndaj mjedisit, pa tretës
- Rezistent ndaj rrezatimit UV dhe kushteve klimaterike
- Aplikim i lehtë
- Mbrojtje nga vaji, nafta dhe uji
- Pakëson ndotjen nga materialet me bazë hidrokarburi
- Rezistent ndaj kripës për shkrirje akulli
- Përmirëson rezistencën gjatë ciklit ngrirje-shkrirje
- Parandalon zhvillimin e mikroorganizmave tek fugat
- Lejon transpirimin e fugave dhe nënshtresave
- Redukton erozionin e rërës
- Lehtëson pastrimin e sipërfaqeve
- Pakëson nevojën për mirëmbajtje
- Përmirëson ngjyrën e nënshtresës
- Redukton efloreshencën

#### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Shpërndarje rrëshire akrilatesh
Ambalazhi	kovë plastike 5 dhe 20 litra
Paraqitja / Ngjyra	Lëng ngjyrë qumështi. I tejdukshëm pas tharjes.
Jetëgjatësia	15 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar.
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në vend të freskët e të thatë. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrirja.
Dendësia	~1.01 kg/l (në +23°C)

Vlera e pH	~9
Viskoziteti	~40 mPas (në +20°C)

## TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca kimike	Rezistencë ndaj ujit të butë agresiv, vajit të makinerive, naftës, benzinës, tretësirave të lehta acide dhe alkaline (kimikate shtëpiake), ushqime (vaj ulliri, salçë keçap, etj). Nuk është i përshtatshëm për ekspozim të lartë kimik.
Rezistenca termike	Ekspozim i përhershëm < +100°C (kushte të thata) Rezistencë e përkohshme ndaj pastrimit me avull

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Normalisht një veshje është e mjaftueshme. Nëse kërkohet mbrojtje e shtuar/rritur kundër ujit dhe vajit ose në rast nënshtrese shumë poroze duhet të aplikohet një veshje e dytë.
----------------------	--

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Holluesi	Sikagard®-907 W është gati për përdorim. Mos e holloni materialin.										
Konsumimi	<i>Mbi blloqe shtrimi me fuga të mbushura me rërë:</i> ~ 0.5 - 1.5 l/m <sup>2</sup> për veshjen e parë (~ 0.6 - 2.0 m <sup>2</sup> /l) sipas porozitetit të nënshtresës dhe thellësisë dhe gjerësisë së fugave. Nëse nevojitet veshje e 2-të, konsumimi është në përgjithësi më i ulët për këtë veshje: ~ 0.100 - 0.200 l/m <sup>2</sup> (~ 5 - 10 m <sup>2</sup> /l)  <i>Sipërfaqe të tjera pa fuga:</i> ~ 0.200 - 0.300 l/m <sup>2</sup> për veshjen e parë (~ 3 - 5 m <sup>2</sup> /l) sipas porozitetit të nënshtresës. Nëse nevojitet veshje e 2-të, konsumimi është në përgjithësi më i ulët për këtë veshje: ~ 0.100 - 0.150 l/m <sup>2</sup> (~ 7 - 10 m <sup>2</sup> /l)										
Temperatura e mjedisit	+5°C min. / +30°C max										
Temperatura e nënshtresës	+5°C min. / +30°C max.										
Koha e pritjes / mbiveshja	Nëse kërkohet veshje e dytë, koha e pritjes midis veshjeve: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Temperatura:</th> <th>+10°C</th> <th>+20°C</th> <th>+30°C</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Koha:</td> <td>5-6 orë</td> <td>~1 orë</td> <td>1/2 deri në 1 orë</td> </tr> </tbody> </table> Shënim: Këto kohë jepen vetëm si një tregues - mund të ndryshojnë në varësi të kushteve të motit (era, lagështia relative, etj.), përmbajtja e lagështisë dhe poroziteti i nënshtresës, etj.	Temperatura:	+10°C	+20°C	+30°C	Koha:	5-6 orë	~1 orë	1/2 deri në 1 orë		
Temperatura:	+10°C	+20°C	+30°C								
Koha:	5-6 orë	~1 orë	1/2 deri në 1 orë								
Metoda e maturimit	Sikagard®-907 W nuk kërkon trajtim, por materiali i freskët i aplikuar duhet të mbrohet nga shiu për të paktën 6 orë në +20°C - dhe më gjatë në temperatura më të ulëta ose në lagështi të lartë.										
Produkti i aplikuar gati për përdorim	<table border="1"> <tbody> <tr> <td>I thatë në prekje:</td> <td>~1 orë</td> </tr> <tr> <td>I thatë për mbledhje pluhuri:</td> <td>~1 - 2 orë</td> </tr> <tr> <td>Qarkullim këmbësorësh:</td> <td>~4 - 5 orë</td> </tr> <tr> <td>Qarkullim i lehtë:</td> <td>~24 orë</td> </tr> <tr> <td>Qarkullim i plotë:</td> <td>~72 orë</td> </tr> </tbody> </table> Shënim: Kohët e mësipërme janë treguese për temperaturë ambiente rreth 20°C - kjo mund të ndryshojë në varësi të kushteve të motit (era, lagështia relative, etj.), përmbajtja e lagështisë dhe poroziteti i nënshtresës, etj.	I thatë në prekje:	~1 orë	I thatë për mbledhje pluhuri:	~1 - 2 orë	Qarkullim këmbësorësh:	~4 - 5 orë	Qarkullim i lehtë:	~24 orë	Qarkullim i plotë:	~72 orë
I thatë në prekje:	~1 orë										
I thatë për mbledhje pluhuri:	~1 - 2 orë										
Qarkullim këmbësorësh:	~4 - 5 orë										
Qarkullim i lehtë:	~24 orë										
Qarkullim i plotë:	~72 orë										

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

#### *Sipërfaqe të reja:*

Siguroni se sipërfaqet e reja janë fshirë mirë, të pastra dhe pa asnjë lloj ndotësi. Duhet të jenë të thata. Për aplikim në fuga të mbushura me rërë, siguroni që rëra të jetë ngjeshur mjaftueshëm (megjithatë shmangni kondesimin e tepruar, pasi kjo do të reduktojë depërtimin e produktit tek fugat).

#### *Sipërfaqe ekzistuese:*

Sipërfaqet ekzistuese duhet të pastrohen me presion për të hequr çdo ndotje. Në varësi të nivelit të kontaminimit, mund të nevojitet përdorimi i pastruesve të posaçëm të sipërfaqeve, si Sikagard®-719 W Universal Cleaner ose Sikagard®-715 W Moss Remover - ndiqni udhëzimet e dhëna tek skedat teknike përkatëse.

Siguroni se sipërfaqja e nënshtresës është e thatë, përpara se të aplikoni Sikagard®-907 W.

Në rastet kur është e vlefshme, sigurohuni se ka mjaftueshëm rërë të pastër dhe thatë tek fugat - nëse kërkohet shtoni sasinë e nevojshme të rërës dhe siguroni ngjeshjen e duhur (shmangni ngjeshjen e tepruar, pasi kjo do të pakësojë depërtimin e produktit tek fugat).

#### *Për punime të reja dhe restaurime:*

Siguroni që rëra tek fugat është plotësisht e thatë - prania e lagështisë do të reduktojë depërtimin e Sikagard®-907 W.

### APLIKIMI

*Për stabilizimin e fugave dhe mbrojtje të sipërfaqeve:* Aplikoni Sikagard®-907 W në mënyrë të njëtrajtshme mbi sipërfaqe me një spërkatës (spërkatës për kopshtin). Lëreni materialin të depërtojë tek fugat për disa minuta përpara se të largoni pjesën e tepruar. Kur aplikimi kryhet mbi blloqe të ashpra dhe të çrregullta, sigurohuni se nuk mbeten pellgje mbi sipërfaqe duke përdorur leckë të pastra kudo që nevojitet. Ndryshe, Sikagard®-907 W mund të aplikohet me spërkatje në presion të ulët duke ndjekur të njëjtën procedurë si më sipër.

Nëse do të nevojitet veshje e dytë për mbrojtje shtesë kundër njollave - nga vaji, ushqimet, etj. - kjo duhet të aplikohet përpara se veshja e parë të thahet. Veshja e dytë duhet të aplikohet me një rul me qime të gjata.

*Vetëm për mbrojtje të sipërfaqes (p.sh. blloqe të shtruara ngjitur pa fuga të mbushura me rërë):*

Aplikoni Sikagard®-907 W në mënyrë të njëtrajtshme mbi sipërfaqe me një rul me qime të gjata.

Nëse do të nevojitet veshje e dytë për mbrojtje shtesë kundër njollave - nga vaji, ushqimet, etj. - kjo duhet të aplikohet përpara se veshja e parë të thahet. Veshja e dytë duhet të aplikohet me një rul me qime të gjata.

### MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë dhe detergjent menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar/tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## KUFIZIME

Mos aplikoni Sikagard®-907 W në rast se:

- Priten shira
- Priten temperatura nën +5°C
- Nëse priten kushtet e pikës së vesës brenda 6 orësh pas aplikimit

Sikagard®-907 W nuk duhet të aplikohet mbi sipërfaqet e mëposhtme:

- Mermer
  - Pllaka qeramike ose terrakota
  - Gur natyror me shkëlqim
  - Në çdo nënshtresë tjetër jo poroze
- Në varësi të ashpërsisë së sipërfaqes dhe konsumimit të ekzagjeruar gjatë aplikimit, Sikagard®-907 W mund të shtojë përkohësisht rrëshqitshmërinë e sipërfaqes. Duhet të kryhen kontrole paraprake në zonat me tendencë lagieje (p.sh. pishina).

Mos aplikoni sasi të tepërt Sikagard®-907 W - mos lini asnjë produkt të mblidhet pellg në sipërfaqe - pastroni me një copë të pastër kudo nevojitet.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

### UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori produkti IIA / i lloji wb) është 140 (Kufizimi 2010) për produktin gati për përdorim. Përmbajtja maksimale e Sikagard®-907 W është < 140 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikagard®-907 W

Mars 2019, Botimi 01.01

020303030090000002

Sikagard-907W-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf